



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 118/1 Prot

Datë 27/2 /2015

V E N D I M

Nr. 03 datë 27.2 .2015

Në mbështetje të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*",

V Ë R E J S E:

Në zbatim të Urdhrit nr. 216 datë 01.12.2014, është ushtruar inspektim administrativ pranë kontrolluesit, "*LOTTO SPORT*" sh.a, me objekt: "*Verifikimi i zbatimit të Urdhrit nr. 07 datë 28/02/2014 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", dhënë ndaj këtij kontrolluesi.

Kontrolluesi "*LOTTO SPORT*" sh.a, nëpërmjet Urdhrit nr. 07, datë 28/02/2014, të Zyrës së Komisionerit, detyrohet që:

- I. Në zbatim të nenit 6 pika 1/a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar:
 - Të fshijë menjëherë të dhënat personale të ankuesit me initiale N.S nga sistemi i mbajtjes së të dhënave dhe në adresë të ankuesit të mos dërgohen më mesazhe promovionale pa marrjen e pëlqimit specifik të tij, për të pranuar mesazhe promovionale;
 - Të marrë pëlqimin specifik të klientëve për të pranuar në adresat e tyre të e-mailit mesazhe promovionale;
 - Mesazhet promovionale të dërgohen vetëm në adresë të subjekteve që kanë dhënë pëlqimin e qartë dhe të shprehur për marrjen e mesazheve promovionale;

- Për çdo subjekt të të dhënave, i cili dëshiron të regjistrohet në sistemin online, të ofrohet mundësia e refuzimit të marrjes së e-mail me qëllim marketingu;
 - Të marrë pëlqimin për të gjithë klientët, të cilët nuk kanë patur mundësi teknike për të dhënë pëlqimin, pasi janë regjistruar para ofrimit të shërbimit të konfirmimit të pëlqimit;
 - Të kontrollojë rregullisht dhe të respektojë regjistrin e përjashtimeve, për subjektet e të dhënave personale të cilëve ju janë drejtuar, por që nuk kanë dëshirë të marrin komunikime të tilla tregtare;
2. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar:
- Të bëjë informimin e subjekteve të të dhënave personale (*klientët, përdoruesit ose vizitorët e sistemit online*) mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim, përhapjen e të dhënave personale dhe sigurinë e tyre;
 - Në faqen e internetit luajmenc@lottosport.com.al të publikojë në një rubrikë të veçantë “*politikat e privatësisë*” (*paketë rregullash*), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshijë kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale.
- Në këtë kuadër është referuar Opinioni “*Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat*”, publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit www.idp.al.
3. Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, në kontratën e lidhur midis kontrolluesit “*LOTTO SPORT*” sh.a dhe përpunuesit “*New Media Communications*”, të parashikojë:
- Palën përgjegjëse për marrjen e pëlqimit specifik të klientëve me qëllim dërgimin e e-mail për fushatë publicitare dhe promocion;
 - Subjektet ku përhapen të dhënat personale të klientëve, duke parashikuar procedurat përkatëse;
 - Në zbatim të kreut VII të Udhëzimit nr. 16, datë 26.12. 2011 për “*Mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë*”, i ndryshuar, të parashikojë masat e sigurisë për përpunimin e të dhënave personale.
4. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të hartojë një rregullore të brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.

Në këtë kuadër është referuar "Rregullorja tip", e cila gjendet e publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit www.idp.al, duke ofruar edhe asistencën tonë.

Për realizimin e detyrimeve të lëna në Urdhër, u përcaktua afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dëgjimit për Urdhërin.

Në zbatim të nenit 32/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, kontrolluesi mbart detyrimin për të njoftuar me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për përmbushjen e detyrimeve të lëna në Urdhër, duke paraqitur edhe provat përkatëse. Nga inspektimi administrativ u konstatua se një gjë e tillë nuk është realizuar.

Nga inspektimi administrativ rezultoi se, kontrolluesi "LOTTO SPORT" sh.a, ka plotësuar pjesërisht, detyrimet që mbart Urdhri nr. 07, datë 28/02/2014, i Komisionerit.

Nga verifikimi i kryer pranë ambienteve të kontrolluesit, në prezencë të Z. _____ (person kontakti për mbrojtjen e të dhënave personale), u konstatua se:

- Kontrolluesi "LOTTO SPORT" sh.a, i ka realizuar detyrimet e parashikuara në pikën 1 të Urdhrit nr. 07, datë 28/02/2014 të Komisionerit, duke:
 - Fshirë të dhënat personale të ankuesit me iniciale _____ nga sistemi i përpunimit të të dhënave. Në sistem nuk rezulton më adresa e e-mailit të ankuesit;
 - Informuar çdo klient, nëpërmjet faqes online, se nëpërmjet regjistrimit pranon marrjen e mesazheve promovionale. Pëlqimi jepet nëpërmjet krijimit të një llogarie nga vetë klienti nëpërmjet faqes online;
 - Dërguar mesazhet promovionale vetëm në adresë të personave që kanë një llogari në faqe;
 - Informuar çdo klient të regjistruar në sistemin elektronik të "LOTTO SPORT" sh.a, nëpërmjet rubrikës "Informativa mbi Privatësinë" dhe e-mailit, se nëse dëshirojnë të mos marrin më e-maile promovionale nga kompania, duhet të klikojnë te linku "Unsubscribe" ose të njoftojnë me e-mail në adresën luajmene@lottosport.com.al, për t'u çregjistruar nga lista e e-maileve promovionale.
- Kontrolluesi nuk e ka marrë pëlqimin për klientët, të cilët nuk kanë patur mundësi teknike për të dhënë pëlqimin, pasi janë regjistruar para ofrimit të shërbimit të konfirmimit të pëlqimit;
- Kontrolluesi e ka realizuar detyrimin për informimin e subjekteve të të dhënave personale (klientët, përdoruesit ose vizitorët e sistemit online) mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, qëllimin e përpunimit dhe të drejtat që gëzojnë, nëpërmjet publikimit të rubrikës "Informativa mbi Privatësinë" në faqen online, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar (referuar pikës 2 të Urdhrit):

- Në kontratën e lidhur midis kontrolluesit "LOTTO SPORT" sh.a dhe përpunuesit "New Media Communications", janë parashikuar rregulla mbi sigurinë e të dhënave dhe mbi administrimin e të dhënave personale në sistem dhe për qëllime promociionale (referuar pikës 3 të Urdhrit);
- Kontrolluesi nuk ka hartuar "Rregulloren e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale", në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar (referuar pikës 4 të Urdhrit).

Administratori i kontrolluesit "LOTTO SPORT" sh.a () e vlerësoi rëndësinë e inspektimit administrativ dhe nëpërmjet procesverbalit të inspektimit deklaroi:

"Do njihemi me mangësitë e mësipërme dhe legjislacionin ku mbështetet puna juaj dhe ju garantojmë që mangësitë e mësipërme do zgjidhen dhe nuk do kemi probleme me legjislacionin tuaj".

Në zbatim të neneve 93-96 të ligjit 8485 datë 12/03/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", më datën 19/01/2015 në ambientet e Zyrës së Komisionerit u zhvillua seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit (), lidhur me konstatimet e grupit të inspektimit administrativ.

Përfaqësuesi i kontrolluesit , në seancë dëgjimore parashitroi faktin se paraqiten vështirësi teknike lidhur me marrjen e pëlqimit për klientët, të cilët nuk kanë patur mundësi teknike për të dhënë pëlqimin, pasi janë regjistruar para ofrimit të shërbimit të konfirmimit të pëlqimit, por kompania ka krijuar mundësinë që këta të fundit të çregjistrohen në çdo kohë pasi në fund të çdo e-maili ekziston opsioni "çregjistrohu tani". Kjo parashikohet edhe në websitin www.lottosport.com.al, në rubrikën "Informativa mbi Privatësinë". Gjithashtu pretendoi se është hartuar rregullorja e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale por gjatë seancës nuk u paraqit si dokument.

Në adresë të Komisionerit, disa ditë pas zhvillimit të seancës dëgjimore, në datë 02.02.2015, (nr.118 prot) kanë mbërritur disa dokumente të dërguara nga kontrolluesi lidhur me inspektimin administrativ të kryer. Dokumentacioni konsiston në: 1) Njoftim mbi masat e marra dhe sqarimet e nevojshme në zbatim të Inspektimit Administrativ datë 03.12.2014, 2) Rregullore (në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008) dhe 3) Opinion ligjor i avokatit të kontraktuar nga Kontrolluesi lidhur me detyrimet e parashikuara në Urdhrit nr. 07, datë 28.02.2014 të Komisionerit.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke vlerësuar konstatimet e bëra dhe qëndrimin e kontrolluesit, "LOTTO SPORT" sh.a, mbi zbatimin e detyrimeve të Urdhrit nr. 07 datë 28/02/2014, të miratuar prej tij, konkludon se:

- Marrja e pëlqimit të klientëve për përpunimin e të dhënave të tyre personale është shumë e rëndësishme pasi përbën shkakun kryesor ligjor për përpunimin e ligjshëm të të

dhënave personale, bazuar në nenin 6 pika 1/a të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar. Kontrolluesi ka përcaktuar një procedurë të rregullt për marrjen e pëlqimit të klientëve nëpërmjet portalit. Gjithashtu sa i përket zgjidhjes së ofruar për klientët të cilët nuk kanë patur mundësi teknike për të dhënë pëlqimin, pasi janë regjistruar para ofrimit të shërbimit të konfirmimit të pëlqimit, vlerësojmë se e përmbush qëllimin e ligjit duke i dhënë mundësinë klientëve që të cregjistrohet. Kjo nënkupton një formë dhënie pëlqimi por të shtyrë në kohë.

- Hartimi i “Rregullores së brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale”, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar, është shumë i rëndësishëm për të sanksionuar punën e përditshme të operatorëve (punonjës të kontrolluesit) që kanë akses dhe përpunojnë të dhënat personale. Nëpërmjet këtij akti garantohej siguria e përpunimit të të dhënave personale duke parashikuar hapat konkrete që duhen marrë në çdo fazë të përpunimit të të dhënave qoftë në mënyrë manuale dhe atë elektronike. Në këtë rregullore nuk reflektohen të gjitha detyrimet ligjore të konstatuara nëpërmjet inspektimeve të ushtruara pranë kontrolluesit dhe nuk është hartuar në përputhje me standardin e publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit.

Komisioneri vlerëson se mospërmbushja në kohë e detyrimit të parashikuar në pikën 4 të Urdhrit nr.07, datë 28/02/2014, të miratuar prej tij, e ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative, sipas nenin 39 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar.

“Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të hartuar rregullore të brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, bazuar në nenin 39, pika 1/dh, të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën nga 10000 deri në 150000 mijë lekë”.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh: faktin se shkelja e konstatuar është serioze pasi lidhet me detyrimin për të marrë masa për sigurinë e të dhënave në zbatim të ligjit, seriozitetin e zbatimit të detyrave që dalin nga Urdhri i Komisionerit, mospërmbushjen në kohë të detyrimit, zbatimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar, neni 39/2 në të cilin parashikohet se “*Personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni*”, faktin që kontrolluesi ka marrë masa për rikuperimin e disa prej shkeljeve të konstatuara paraprakisht.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 27, 29, 30/2, 39/1/dh, 40 e 41, të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe 107-109 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "LOTTO SPORT" sh.a, me gjobë në vlerën **50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

